



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 01 Dhjetor 2022

Nr: 212

Ora: 11.00

VENDIM

PËR

DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË KOALICIONIT "PARTIA DEMOKRATIKE-ALEANCA PËR NDRYSHIM", QARKU TIRANË, ZJ. ORJELA LUFTAR NEBIJAJ

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat "i", "n" e 2, 163 pika 7, 164 pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", dhe të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 3719/1 prot., datë 09.11.2022, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, vakancë kjo e krijuar si pasojë e dorëheqjes nga mandati i deputetit, të zj. Grida Agim Duma, e zgjedhur në zonën zgjedhore, Qarku Tiranë, propozuar nga koalicioni "Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim".

Koalicioni "Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim", është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 107, datë 02.03.2021.

Komisioni Rregullator me vendimin nr. 21, datë 13.07.2021, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të zhvilluara në datë 25.04.2021.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nëpërmjet vendimit nr. 409, datë 23.06.2021 miratoi shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, përcaktimin e kandidatëve fitues si dhe rirenditjen e kandidatëve të cilët nuk kanë përfituar mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese në zonën zgjedhore, Qarku Tiranë. Sipas këtij vendimi koalicioni "Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim" për zonën zgjedhore, Qarku Tiranë, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, ka fituar 15 (pesëmbëdhjetë) mandate

Rezulton se lista shumemërore e koalicionit “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim”, në zonën zgjedhore, Qarku Tiranë, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë.

Zëvendësimi i vakancës do të bëhet në mbështetje të nenit 164 pika 2, të Kodit Zgjedhor si dhe vendimit nr. 409, datë 23.06.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në të cilin është miratuar rirënditja e kandidatëve, të cilët nuk kanë përfituar mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese.

Sipas këtij vendimi, rezulton se, kandidati të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati me numër rendor 17 (shtatëmbëdhjetë), zj. Orjela Luftar Nebijaj.

Me shkresën nr. 3543 prot., datë 10.11.2022, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidati për deputet, të listës shumemërore të koalicionit “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim”, në zonën zgjedhore, Qarku Tiranë, zj.Orjela Luftar Nebijaj, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant.

Kandidati për deputet, zj. Orjela Luftar Nebijaj, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 53 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i deputetit.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Orjela Luftar Nebijaj, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me ndalimet që parashikon ligji nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, me shkresën nr. 3615 prot., datë 18.11.2022 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 3617 prot., datë 18.11.2022 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për zj. Orjela Luftar Nebijaj, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për zj. Orjela Luftar Nebijaj.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr.13596/1 prot., datë 21.11.2022, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për zj. Orjela Luftar Nebijaj, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidati për deputet, në zonën zgjedhore, Qarku Tiranë, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, zj. Orjela Luftar Nebijaj, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidati në funksionin e deputetit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i deputetit zj. Grida Agim Duma, i përket kandidatit vijues në listën shumemërore të koalicionit “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim”, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, i renditur me numër rendor 17 (shtatëmbëdhjetë), zj. Orjela Luftar Nebijaj.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, 163 pika 7, 164 pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe në Kreun V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

VENDOS:

1. Dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të koalicionit “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim”, në zonën zgjedhore, Qarku Tiranë, zj. Orjela Luftar Nebijaj.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI